



Nr. 2 Prot

Tiranë, më 13.04.2016

OBJEKTI: Miratohet Rregullorja "Për mënyrën e funksionimit, të shqyrtimit të ankesave dhe vendimarrjes të Komisionit të Apelit të Universitetit të Arteve, Tiranë".

VENDIMI Nr. 2

Bazuar në Rregulloren nr. 2459/1, datë 15.03.2016 "Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë", të miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit, me shkresën nr.110 datë 15.03.2016, neni 39, pika 4; të mërkurën, datë 13.04.2016, Komisioni i Apelit të Universitetit të Arteve, në prani të pesë anëtarëve, hartoi dhe miratoi me shumicë votash rregulloren "Për mënyrën e funksionimit, të shqyrtimit të ankesave dhe vendimarrjes të Komisionit të Apelit të Universitetit të Arteve, Tiranë".

Kjo rregullore bëhet publike në faqen zyrtare të internetit të UART.

KOMISIONI I APELIMIT TË UART:

Esmeralda SELITA – Kryetar

Ardian KAPO – Sekretar

Ilirjana DEMA – Anëtar

Migena DUSHKU – Anëtar

Iliriana TOPULLI – Anëtar



RREGULLORE PËR MËNYRËN E FUNKSIONIMIT, TË SHQYRTIMIT TË ANKESAVE DHE VENDIMARRJES TË KOMISIONIT TË APELIMIT TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE, TIRANË

Neni 1

Komisioni i Apelimit (më poshtë referuar si KA) përbëhet nga 5 anëtarë. KA krijohet dhe funksionon sipas rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë", të miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit, me shkresën nr.110 datë 15.03.2016, neni 39, si dhe në zbatim të rregullave të mëposhtëme.

Neni 2

Mandati i anëtarit të KA-së dhe mbarimi i tij

1. Komisioni i Apelimit i ushtron funksionet e tij për një mandat 4-vjeçar. Anëtarët e Komisionit të Apelimit shpërblehen për punën që bëjnë.
2. Mbarimi i mandatit të anëtarit të KA-së mbaron para afatit 4-vjeçar, kur:
 - a. Plotësohen kushtet e parashikuara në pikën 2 të nenit 39 të rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë".
 - b. Jep dorëheqjen për arsye personale.
 - c. Nuk paraqitet në mbledhjen e KA-së dy herë rresht, pas thirrjes së mbledhjes nga Kryetari i KA-së.
 - d. Shkel rregullat e etikës së IAL-së dhe me veprimet, apo mosveprimet tij pengon hapur veprimtarinë e KA-së.
3. Në rastet e parashikuara në pikat (c) dhe (d) të mësipërme, vendimin për mbarimin e mandatit të anëtarit të KA-së, e merr vetë KA-ja me shumicën e votave të 5 anëtareve të saj (minimum me 3 vota pro). Ky vendim i dërgohet menjëherë, sipas rastit, Senatit të UART ose MAS, për plotësimin e vendit të anëtarit që është vakant.

Neni 3

Rregullat për administrimin dhe afatet e ankimit

1. KA-ja merr në shqyrtim dhe vendos vetëm për ankimet kundër vendimeve të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (më poshtë KIZ) të Universitetit të Arteve, Tiranë, të ngritur sipas rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë".
2. Vendimi i KIZ-së është i ankimeshëm, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e shpalljes së vendimit nga KIZ-i. Periudha 5 ditore fillon në orën 16.00 të ditës së shpalljes së aktit, për të cilin bëhet ankimi dhe përfundon në orën 16.00, pas 5 ditëve kalendarike.
3. Ankimi kundër vendimit të KIZ-së mund të bëhet nga çdo subjekt që ka një interes të drejtpërdrejtë me vendimin e KIZ-it.
4. Ankimi paraqitet me shkrim dhe dorëzohet pranë Universitetit të Arteve, Tiranë, për Komisionin e Apelimit.



5. Ankimi duhet të shoqërohet detyrimisht me Vendimin e KIZ-së që është objekti i ankimit, si dhe me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për sqarimin e pretendimeve të ngritura në ankim.
6. Me marrjen në dorëzim të ankimit me shkrim, Kryetari i KA-së thërret mbledhjen e KA-së për shqyrtimin dhe marrjen e vendimit përkatës mbi ankimin e paraqitur.

Neni 4

Proces-verbali i mbledhjes së KA-së

1. Për çdo mbledhje të KA-së, mbahet proces-verbali i mbledhjes të KA-së.
2. Në procesverbal bëhet një përmbledhje e gjithçkaje u tha në mbledhje, data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën, si dhe forma dhe rezultati i votimeve.
3. Procesverbali mbahet nga Sekretari i KA-së dhe duhet t'u paraqitet për nënshkrim të gjithë anëtarëve në fund të mbledhjes ose në fillim të mbledhjes pasardhëse.
4. Procesverbali nënshkruhet detyrimisht nga Kryetari dhe Sekretari i KA-së.

Neni 5

Mbledhjet e KA-së, kuorumi dhe vendimarrja

1. KA, gjatë periudhës së organizimit të zgjedhjeve në UART, mblidhet jo më pak se një herë në javë. Në rastin kur është depozituar ankim pranë KA-së, ky i fundit mblidhet çdo ditë, deri në shqyrtimin dhe marrjen e vendimit përkatës.
2. Thirrja e mbledhjes bëhet nga Kryetari i KA-së.
3. Mbledhja e KA-së është e vlefshme kur në të marrin pjesë të gjitha anëtarët e saj (5 anëtarë). Nëse kjo shumicë nuk realizohet, mbledhja e radhës është e vlefshme nëse në të marrin pjesë jo më pak se 3 anëtarë.
4. Në rast të mungesës, pa shkak të justifikuar, të anëtarëve të KA-së në mbledhjet e KA-së, merren masa për mbarimin e mandatit të anëtarit të KA-së, sipas kriterëve të dispozitave të kësaj Rregulloreje.
5. Vendimi nga KA, miratohet me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të saj (minimum 3 vota pro).
6. KA ka të drejtë të thërrasë në mbledhjet e saj përfaqësues të KZF-ve apo të KIZ-së, si dhe vetë ankimuesin për të dhënë shpjegimet përkatëse në lidhje me ankimin e paraqitur.
7. KA ka të drejtë të kërkojë, të gjithë dokumentacionin e nevojshëm nga KZF-të apo KIZ-ja, apo edhe nga organet drejtuese të UART.
8. Kryetari i KA-së raporton para KA-së mbi ankimin e paraqitur, pretendimet e ngritura, baza ligjore dhe Vendimin e KIZ-së objekt ankimi.
9. Çdo anëtar i KA-së ka të drejtë të barabartë dhe të plotë të bëjë pyetje dhe diskutime në lidhje me ankimin e paraqitur. Këto pyetje dhe diskutime drejtohen nga Kryetari i KA-së. Nëse vendimarrja kërkon kohë, KA vazhdon mbledhjen në ditën e nesërme dhe në ditën në vazhdim, po gjithmonë duke respektuar afatin e përgjithshëm 10 ditor.
10. Në fund të diskutimeve, Kryetari i KA-së e kalon çështjen në votim. Votimi bëhet i hapur nga çdo anëtar i KA-së dhe çdo votë "pro" ose "kundër" regjistrohet në proces-verbalin e mbledhjes së KA-së.

Neni 6

Afati i vendimarrjes së KA-së



Neni 6

Afati i vendimarrjes së KA-së

1. Komisioni i Apelimit shprehet me vendim të arsyetuar brenda 10 ditëve kalendarike.
2. Periudha 10 ditore fillon në orën 16.00 të ditës së paraqitjes së ankimit me shkrim dhe përfundon në orën 16.00, pas 10 ditëve kalendarike.

Neni 7

Forma dhe përmbajtja e vendimit të KA-së

1. Vendimi i KA-së hartohet me shkrim.
2. Vendimi i KA-së përmban detyrimisht:
 - a. Emrin e ankuesit, datën e paraqitjes dhe përmbajtjen e ankimit.
 - b. Pjesën argumentuese.
 - c. Dispozitivin e vendimit në të cilin KA disponon mbi çdo pikë të ankimit të paraqitur, për të cilën KA ka autoritet të marrë vendim.
3. Përmbajtja e përmbledhur e vendimit të marrë shënohet në proces-verbalin e mbledhjes së KA-së.
4. Vendimi i KA-së firmoset detyrimisht nga të gjithë anëtarët e KA-së të pranishëm në mbledhje.
5. Votat "kundër" mund të shënohen në vendim si dhe argumentimi përkatës i kësaj vote pasqyrohet me shkrim nga vetë anëtari i KA-së që ka votuar "kundër".
6. Vendimi ka një nr.rendor dhe një datë të miratimit të tij.

Neni 8

Njoftimi i vendimit të KA-së dhe efektet e vendimit

1. Vendimi i KA-së i njoftohet menjëherë ankimuesit. Për këtë qëllim Kryetari i KA-së harton një dokument ku vërtetohet marrja dijeni për vendimin, i cili firmoset nga marrësi i vendimit.
2. Vendimi i KA-së i njoftohet menjëherë KIZ-së. Për këtë qëllim Kryetari i KA-së harton një dokument ku vërtetohet marrja dijeni për vendimin, i cili firmoset nga Kryetari i KIZ-së.
3. Vendimi i KA-së është i formës së prerë, përfundimtar dhe i detyruar për t'u zbatuar nga KIZ-ja e UART dhe të gjitha organet e tjera të administrimit të zgjedhjeve në UART.
4. Kundër vendimeve të KA-së, mund të bëhet ankim në rrugë gjyqësore nga pala që ka interes të ligjshëm, sipas afateve të parashikuara në legjislacionin në fuqi, për kundërshtimin gjyqësor të akteve administrative.

Neni 9

Dispozita të fundit

1. Kjo rregullore është e vlefshme për zgjedhjet që do të zhvillohen në UART në datën 20 Prill 2016, si dhe për të gjitha zgjedhjet e pjesëshme që mund të zhvillohen në UART, brenda afatit 4 vjeçar nga marrja e mandatit të organeve që do të konstituohen nga zgjedhjet e datës 20 prill 2016.
2. Kjo rregullore mund të ndryshohet vetëm me vendim me shkrim të Komisionit të Apelimit.

Për Komisionin e Apelimit të Universitetit të Arteve:

Esmeralda SELITA - Kryetare

Ardian KAPO - Sekretar